



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivety	22. 09 2023	3	vit god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pitlog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SPANSHAK	6201/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1130/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1130/2023 të datës 30.08.2023 të ankuesit në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.09.2023, mori këtë.

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1130/2023 e datës 30.08.2023 e parashtruara nga ankuesi

II.Mbetet në fuqi Vendimi nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit me nr. 01 Nr.070/01-43506 i datës 30.08.2023.

A r s y e t i m

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit me datë 17.07.2023 ka shpallur konkursin për emrin e grupit "Specialist të Prokurimit Publik (RN00012091-Zyrtarë i Prokurimit 2,klasa e pozitës Profesional 2)" në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi Alban Fejzullahu, mirëpo sipas njoftimit me Nr.02-111/01-23233 të datës 25.08.2023 i është refuzuar aplikacioni me numër të kodit RPC0005671 ndërsa ndaj këtij njoftimi ankuesi kishte paraqitur ankesë në Njësinë Përgjegjëse të Institucionit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore më datë 30.08.2023 përmes Vendimit 01 Nr.070/01-43506 i kishte

refuzuar ankesën për shkak se i njëjti nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit dhe poashtu nuk kishte plotësuar kriterin e përvojës punës.

Ankuesi ndaj këtij vendimi 01 Nr.070/01-43506 të datës 30.08.2023 (përkundër që nuk ka specifikuar vendimin)ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 30.08 .2023 me pretendimet ankimore se është i vetëdijshëm se me rastin e aplikimit online përmes SIMBNJ nuk e ka bashkangjitur edhe Certifikatën e lëshuar nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, ndërsa pretendon se nuk është kërkuar ky dokument në përmbajtjen e shpalljes së konkursit sipas pikës 7 të të njëjtit konkurs po ashtu ne shpalljen e konkursit nuk ka qenë kriter përvoja profesionale, por vetëm përvoja e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar me datë 31.08.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Drenasit. Ndërsa Këshilli me datë 04.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.08.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komune e Drenasit me 01 Nr.070/01-43506 të datës 30.08.2023; Njoftimit me Nr.02-111/01-23233 të datës 25.08.2023 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komune e Drenasit; Trusti i ankuesit e datës 2208.2023; Konkursi i datës 17.07.2023 nga Komuna e Drenasit; Përgjigja në ankesë e datës 01.09.2023; Aplikacioni i ankuesit i datës 09.08.2023; Diploma e ankuesit me nr.201 e datës 23.12.2022; Referencë nga "Muli Shoes" e datës 01.10.2020; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Certifikatë nga RDA e Tetor 2020; Certifikatë nga RDA e Shtator 2020; Njoftimit me Nr.02-111/01-23233 të datës 25.08.2023 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komune e Drenasit për kandidatet e suksesshëm; Detajet e aplikacionit në simbnj për ankuesin; Email i datës 30.08.2023; Email i datës 30.08.2023; Shkresë nga simbnj; Vendim me 01 Nr.090/04-30573 i datës 27.06.2023 nga Kryetari Komunës së Drenasit; Njoftim me rezultatet e verifikimit përfundimtar të kandidateve për grupin Specialist të Prokurimit Publik; Lista e aplikantëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me objektin e kësaj ankese konstaton se në konkursin e shpallur të datës 17.07.2023, për grupin e pozitave "Specialist të Prokurimit Publik - RN00012091-Zyrtarë i Prokurimit 2,klasa e pozitës Profesional 2)", kërkesat e përgjithshme për pranim kanë qenë :*"Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, tëpushuar sipas këtij ligji"*,si dhe kërkesat e përgjithshme formale në lidhje me konkursin e shpallur nga Komuna e Drenasit për këtë konkurs, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimimi i kërkuar* :Diplomë e arsimit të lartë Fakulteti Ekonomik (pavarësisht nga specializimi)/Juridik dhe Administratë Publike më së paku tre (3) vite të studimeve.
- *Kualifikime të Posaçme formale*: Certifikata në këtë fushë ku kërkohet plotësimi i pozitës(qertifikata themelore për prokurim publik);
- *Përvoja e punës e kërkuar*: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ne baze të shkresave të lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se në konkursin, për emrin e grupit "Specialist të Prokurimit Publik- RN00012091-Zyrtarë i Prokurimit 2,klasa e pozitës Profesional 2, të shpallur nga Komuna e Drenasit sipas njoftimit datës 17.07.2023 me afat aplikimi nga data 07.08.2023 deri me datë 20.04.2023, ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo sipas njoftimit me Nr.02-111/01-23233 të datës 25.08.2023 të njëjtit i është refuzuar aplikacioni me numër të kodit RPC0005671 ndërsa ndaj këtij njoftimi ankuesi kishte paraqitur ankesë në Njësinë Përgjegjëse të Institucionit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore më datë 30.08.2023 përmes Vendimit 01 Nr.070/01-43506 i kishte refuzuar ankesën për shkak se i njëjti nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit dhe poashtu nuk kishte plotësuar kriterin e përvojës punës, ashtu siç është kërkuar me konkurs respektivisht ankuesi nuk e ka plotësuar kriterin e konkursit i cili kishte paraparë :*"Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës"*, çka nënkupton se kemi të bëjmë me përvojë pune profesionale dhe që kjo përvojë duhet të jetë e fituar pas shkollimit universitar përkatësisht pas diplomimit ndërsa ankuesi ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën e punës por se sipas dëshmive nuk plotësohet kjo kërkesë elementare sa i përket përvojës së punës profesionale sepse i njëjti ka diplomuar më 26.09.2022 përderisa konkursi është shpallur më datë 17.07.2023 me afat aplikimi nga data 07.08.2023 deri me datë 20.04.2023.

Andaj, nga ajo që u tha si më lartë përkatësisht llogaritjen e përvojës së punës e cila llogaritet pas diplomimit, Këshilli me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë i është referuar Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se për pozitën profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka analizuar edhe dispozitat Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 12 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Aplikacioni përmban këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurrimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsyet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe numri i kontaktit të dy (2) personave referues;"* dhe paragrafi 2, ku thuhet *"Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e*

konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”, poashtu edhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet: “Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve” dhe paragrafin 6. ku thuhet se: Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj” dhe referuar bazës ligjore si më lartë me qenë se konstatohet se ankuesi nuk ka plotësuar kushtin e përvojës së punës prej një viti të konfirmuar nga dokumentacioni i dorëzuar nga vetë ankuesi, i njëjti nuk ka mundur të vazhdojë më tutje me fazat tjera të procesit të konkurimit dhe në këtë kuptim Vendimi nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit me nr. 01 Nr.070/01-43506 të datës 30.08.2023 mbi refuzimin e ankesës së ankuesit është i drejtë dhe i ligjshëm, gjithashtu kolegji i këshillit nuk u lëshue në shqyrtim të pretendimit tjetër sa i përket çështjes së mosdorëzimit të Certifikatës së lëshuar nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje për faktin se nuk ka ndikim vendimtarë në këtë situatë për arsyen e asaj që u konstatue si më lartë sa i përket përvojës së punës andaj mbi konstatimin e gjendjes faktike si më lartë dhe bazës ligjore të potencuar në arsyetim të këtij vendimi Kolegji i Këshillit vendosi se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe e njëjta refuzohet si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1130/2023, datë 22/09/2023.

Vjollca Sinani

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

